



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 07.04.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 8831, datë 22.11.2001 “Për pronësinë shtetërore në shoqëritë tregtare financiare me kapital tërësisht shtetëror””.
3. Projektligji “Për sektorin e energjisë elektrike”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Armando Subashi, Blendi Klosi, Dashamir Peza, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Petrit Vasili, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Vexhi Muçmataj, Silva Caka, Mhill Fufi, Eduard Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu, Tahir Muhedini, Nard Ndoka, Pirro Lutaj.

Mungojnë:

Tom Doshi,

Të ftuar:

Arben Ahmetaj – ministër i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes
Zamir Stefani – drejtor i Privatizimit të Pronës Shtetërore në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Ardit Çollaku – këshilltar i ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Arvid Uruci – përgjegjës i Sektorit Juridik në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Agim Bregasi – drejtor i Politikave të Planifikimit Strategjik të Energjisë në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë

Entela Çipa – këshilltare e ministrit të Energjisë dhe Industrisë

Enea Karakaci – përgjegjës i Sektorit të Legjislacionit në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Përshëndetje!

Meqenëse realizohet kuorumi, fillojmë mbledhjen e komisionit.

Sot në rendin e ditës kemi projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr. 8831, datë 22.11.2001 “Për pronësinë shtetërore në shoqëritë tregtare financiare me kapital tërësisht shtetëror””, si dhe vazhdimin e diskutimit dhe votimin në parim, pse jo edhe nen për nen, po të arrijmë, të projektligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”.

Në fillim do të shqyrtojmë projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr. 8831, datë 22.11.2001 “Për pronësinë shtetërore në shoqëritë tregtare financiare me kapital tërësisht shtetëror””.

Për të paraqitur iniciativën dhe për ta mbrojtur atë ka ardhur zoti Arben Ahmetaj, ministër i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, së bashku me stafin e tij.

Mirë se keni ardhur, zoti Ministër!

Në fillim do të dëgjojmë një ekspozë të ministrit për qëllimin e kësaj iniciative ligjvënëse të sjellë nga Këshilli i Ministrave, më pas do të kalojmë në pyetje dhe diskutime.

Zoti Ministër, fjala është për ju.

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Qëllimi i projektaktit është ndryshimi i ligjit nr. 8831, datë 22.11.2001 “Për pronësinë shtetërore në shoqëritë tregtare financiare me kapital tërësisht shtetëror”. Këtij ndryshimi i ka paraprirë edhe ndryshimi i ligjit që është bërë para dy javëve në Kuvendin e Shqipërisë “Për formulën e privatizimit të shoqërisë me kapital tërësisht shtetëror, INSIG”. E drejta e përfaqësimit me pronarin shtet mbi aksionet e INSIG-ut i ka mbetur ende Ministrisë së Financave që prej vitit 1996, meqenëse në atë kohë kompania barazohej me bankat e nivelit të dytë, në të cilat shteti gëzonte të drejtën mbi aksionet. Aktualisht nuk ka asnjë bankë të nivelit të dytë në të cilën shteti gëzon të drejtën mbi aksionet. Çështja e lidhur me kompaninë INSIG sh.a nuk ka të bëjë me administrimin, por me privatizimin e kompanisë.

Kalimi i të drejtës së përfaqësimit të pronarit shtet te Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes do t’i shërbejë unifikimit të trajtimit të këtyre tagreve me kompanitë e tjera, në të cilat shteti gëzon të drejta mbi aksionet. Ky ndryshim ligjor është i lidhur edhe me shfuqizimin, siç e thashë më parë, e ligjit nr. 10168, datë 22.10.2009 “Për përcaktimin e formës dhe formulës së privatizimit të INSIG sh.a”.

Kompania ka qenë pjesë e aseteve strategjike dhe në fillimet e saja është trajtuar në bazë të ligjit nr. 8306, neni 4, ku shoqëritë e sigurimeve me kapital tërësisht shtetëror

konsideroheshin sektorë me rëndësi të veçantë të ekonomisë dhe në procesin e tyre të privatizimit trajtoheshin me ligj të veçantë, ku përcaktohej edhe forma, edhe mënyra e privatizimit.

Para vitit 2009 u tentua të privatizohej kompania dhe oferta në kuadrin e kompanive strategjike, aseteve strategjike, për sektorët me rëndësi të veçantë, ka ardhur e bardhë. Pra, ka dështuar praktikisht privatizimi. Në vitin 2009 u vendos që shoqëritë e sigurimit me kapital tërësisht shtetëror të dilnin nga sektorët me rëndësi të veçantë dhe nga asetet strategjike dhe të trajtoheshin si të gjitha asetet e tjera publike. Ndërkohë me dy ligjet e fundit ne kemi shfuqizuar ligjin që ishte ende në fuqi “Për formën dhe formulën e privatizimit” dhe tani, për të unifikuar trajtimin në proces, pronësia kalon te Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. Administrator deri në momentin e privatizimit do të mbetet sërish Ministria e Financave, siç ka qenë deri tani, por procedurat do të kryhen nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. Pak a shumë ky është qëllimi dhe formati.

Në këndvështrimin tim është një ndryshim i drejtpërdrejtë për të bërë të mundur futjen menjëherë në proces privatizimi të kompanisë. Dua të theksoj se kompania sot është në një situatë të vështirë financiare, e cila është trashëguar. Kosova vazhdon me humbje dhe me probleme me autoritetin financiar. Maqedonia ka një fitim modest. Shqipëria, me vështirësitë e saja, në vite e ka humbur tregun dhe ka vajtur në më pak se 7%. Pra, përfaqëson një kompani, e cila nuk është as e para, as e dyta dhe as e treta në sektorin e sigurimeve. Thënë kjo, ne mendojmë se ka ardhur momenti të bëjmë një përpjekje të dytë për ta privatizuar, që besojmë se do të jetë e suksesshme. Ky është edhe qëllimi i ndryshimeve që kemi sjellë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Ministër!

Zonja Caka, fjala është për ju, në cilësinë e relatores.

Silva Caka – Në fakt, nuk është se ka ndonjë gjë për të shtuar.

Për sa i përket kriterit procedural dhe atij ligjor, projektligji është në përputhje me të gjitha kriteret e përcaktuara. Por gjatë shqyrtimit nën për nen dua të bëj një ndryshim të karakterit të teknikës legjislative.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Pasi dëgjuam ekspozenë dhe argumentet e sjella nga ministri, si dhe qëndrimin pro projektit nga relatorja, kalojmë në pyetje.

Zoti Fino, keni fjalën.

Bashkim Fino – Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti Ahmetaj, përtej projektligjit që ka ardhur, ju na folët edhe për situatën aktuale të INSIG-ut. Sot ju kërkoni nga ne që ministri i Ekonomisë të jetë në emër të shtetit pronari i shoqërisë së sigurimeve...

Fatmir Xhafaj – Me kapital tërësisht shtetëror.

Bashkim Fino – Po, po.

Pyetja ime lidhet me nenin 1. Pra, pyetja ime nuk është për ministrinë në fjalë, por për Ministrinë e Financave. Në nenin 1 thuhet: “Ministria e Financave do të veprojë në emër të shtetit për bankat e nivelit të dytë”. Pra, ne kemi një projektligj me dy nene. Bankat e nivelit të dytë do të kalojnë në emër të shtetit nga Ministria e Financave dhe gjithë pjesa e sigurimeve kalojnë te ministri i Ekonomisë në emër të shtetit. Prandaj këtu duhet të ishin të pranishëm edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Financave, që ne t’i pyesnim për bankat e nivelit të dytë. Përderisa nuk është as ministri, as një përfaqësues, unë nuk mund të bëj pyetje.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ju bëtë një koment. Ministri është përfaqësues i qeverisë dhe projektligji është i qeverisë. Ministri prandaj ka ardhur.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Absolutisht.

Përderisa ka sjellë një projektligji të qeverisë, ai mund të përgjigjet për çdo gjë që ka lidhje me projektligjin e qeverisë.

Zoti Ministër, keni fjalën.

Arben Ahmetaj – Asgjë nuk ndryshon në administrim të kompanisë. Praktikisht ministri i Financave do të vazhdojë të jetë administratori, pra administrimin do ta ketë Ministria e Financave. Neni 1 nuk ka ndryshuar. Ne nuk kemi asnjë bankë të nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror. Pra, megjithëse këtu neni është në parim, praktikisht nuk ka. Institucioni i vetëm financiar që është me kapital tërësisht shtetëror dhe me pronësi deri më sot ministrin e Financave ndryshon, por administrimi nuk ndryshon.

Ndërkohë, ministri i Financave është në Komisionin e Ekonomisë, sepse po mbron një ligj tjetër.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Ahmetaj!

Zoti Halimi, keni fjalën.

Eduard Halimi – Nga pikëpamja kushtetuese-ligjore për ne si komision pak rëndësi ka nëse do t’i përfaqësojë një ministër apo një tjetër. Si anëtar i Kuvendit unë nuk e gjej dot, zoti Ministër, motivin pse duhet t’ia heqim INSIG-un Ministrisë së Financave dhe t’jua japim juve. Argumenti juaj ishte: nuk e privatizon dot ministri i Financave, sepse e privatizoni ju.

Vetëm ky është argument? Domethënë, vetëm për këtë duhet të votojmë ne? Pse duhet të votojmë për këtë gjë, kur ne mendojmë se privatizimin mund ta bëjë edhe zoti Cani?

Fatmir Xhafaj – Kjo ka lidhje edhe me një projektligj që kemi kaluar pak më parë në Kuvend.

Arben Ahmetaj – Zoti Halimi, atë e thatë ju, jo unë.

Unë thashë se procedurat unifikohen dhe bëhen nga ministria përgjegjëse për Ekonominë, si të gjitha asetet dhe ndërmarrjet kapital tërësisht shtetëror. Kjo është ajo që thashë unë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Ka pyetje të tjera? Nuk ka. Ka diskutime? Nuk ka.

Kush është dakord me projektligjin në parim? Kundër? 3 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet projektligji në parim.

Kalojmë në shqyrtimin nen për nen.

Neni 1? Urdhëroni!

Silva Caka – Pas nenit 1 duhet të shtohen fjalët: “Neni 1 ndryshohet si më poshtë”, pasi nuk është e përcaktuar, në mënyrë që të kuptohet se çfarë po bëhet.

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

Dakord?

Miratohet neni 1.

Neni 2? Dakord.

Kush është dakord me projektligjin në tërësi? Kundër? 4 kundër Abstenim? Nuk ka.

Miratohet projektligji në tërësi.

Faleminderit, zoti Ministër, që ishit i pranishëm bashkë me ekipin tuaj!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti kryetar!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 07.04.2015, ora 10:20

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për sektorin e energjisë elektrike”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Armando Subashi, Blendi Klosi, Dashamir Peza, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Petrit Vasili, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Vexhi Muçmataj, Silva Caka, Mhill Fufi, Eduard Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu, Tahir Muhedini, Nard Ndoka, Pirro Lutaj.

Mungojnë:

Tom Doshi.

Të ftuar:

Agim Bregasi – drejtor i Politikave të Planifikimit Strategjik të Energjisë në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë

Entela Çipa – këshilltare e ministrit të Energjisë dhe Industrisë

Enea Karakaci – përgjegjës i Sektorit të Legjislacionit në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë

Fatmir Xhafaj – Kalojmë në shqyrtimin e projektligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”.

(Mungesë incizimi.)

Zoti Halimi, keni fjalën.

Eduard Halimi – Në seancën e kaluar i drejtuam disa pyetje ministrisë përkatëse në lidhje me avantazhet që sjell ky projektligj për qytetarët shqiptarë. Sigurisht, ky projektligj nuk u sjell asgjë të mirë shqiptarëve. Nuk heq kamatëvonesat, nuk ul çmimin e energjisë elektrike, nuk sjell asnjë garanci më shumë, përveçse shtrëngon darën dhe rrit barrën për çdo qytetar shqiptar, çdo konsumator të energjisë elektrike, çështje që kolegët tanë në komisionet përkatëse do t’i trajtojnë me hollësi.

Shqetësimi që kam unë si anëtar i Komisionit të Ligjeve ka të bëjë me një shqetësim kushtetues, me sekuestrimin që OSHEE-ja kërkon t’u bëjë pasurive të qytetarëve shqiptarë në rast se borxhi që ata kanë ndaj qeverisë është më shumë se 150 mijë lekë të rinj.

Sipas parashikimeve të bëra në germën “b” të nenit 90 të projektligjit, të firmosur nga Kryeministri: “Në rast se detyrimi i papaguar është më shumë se 150 mijë lekë të rinj, atëherë furnizuesi, pra qeveria, ka të drejtë të zbatojë mjetin e sigurimeve të detyrimeve të papaguara, duke vendosur barrë hipotekore mbi pasurinë e paluajtshme që furnizohet me energji elektrike”. Pra, e thënë ndryshe: OSHEE-ja e Kryeministrit do të sekuestrojë (barra hipotekore është baras me sekuestrim, jo me konfiskim, siç u ngatërrua zëvendësministri në seancën e kaluar) të gjitha pasuritë e debitorit të energjisë elektrike, pra të konsumatorit, të qytetarëve: shtëpi, apartamente, tokë bujqësore, truall, dyqan dhe çfarë të kenë. Pas burgut, tani qytetarët i pret sekuestrimi i pasurive. Këtë nuk kërkon ta bëjë siç parashikohet në Kodin e Procedurës Civile, siç parashikohet në Kodin Civil, siç parashikohet në Kushtetutë, por automatikisht furnizuesi, baras Kryeministri. Ai i kërkon parlamentit, pra edhe neve si deputetë, që të firmosë një projektligj, ku të jetë kryegjykatës dhe kryepërmbarues.

Ky projektligj për ne është jo vetëm antikushtetues, por mbi të gjitha një barbari juridike deri në këtë moment, ndoshta do ta ndryshojmë më vonë.

Së pari, detyrimi i pagimit të faturës së energjisë elektrike është detyrim në para, për ekzekutimin e të cilit ndiqen rregullat e parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile. Fatura e energjisë është titull ekzekutiv, por ekzekutimi bëhet nga përmbaruesi vetëm pasi të shprehet gjykata më parë në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit. Pra, nëse 150 mijë lekë, nëse 100 mijë lekë, nëse është 50 mijë lekë. Atëherë, para se të shkojë taksidari i Kryeministrit, duhet që gjykata të vendosë mbi masën e sekuestrimit që do të jetë. Për 50 mijë

lekë do të sekuestrojë një send të luajtshëm dhe jo të vendoset sekuestro mbi të gjitha pasuritë që furnizohen me energji elektrike, siç parashikon Kryeministri në këtë projektligj.

Të sekuestrosh banesat bujqësore dhe troje që kanë vlerë qindra herë më të mëdha se një faturë energjie prej 150 mijë lekësh, për më tepër ta bësh këtë pa autoritetin gjyqësor, pra pa ia nënshtruar gjykatës, por vetëm si Kryeministër, për mua është një barbari ligjore. Deri në lëshimin e urdhrit të ekzekutimit kreditori nuk mund të ndërmarrë, pra OSHEE-ja, Kryeministri, asnjë masë për ekzekutimin e detyrimit, sepse ekzistenca e tij nuk është provuar gjyqësish. Prandaj një parashikim i tillë bie në kundërshtim të plotë me Kodin e Procedurës Civile, konkretisht me nenet 511 dhe 527 “Vendosja e sekuestros”, ku thuhet: “Kur kërkohet ekzekutimi i detyrimit në të holla, përmbaruesi gjyqësor është ai që, me kalimin e afatit të lajmërimit vullnetar, fillon ekzekutimin e detyrueshëm, pasi të ketë marrë më parë vendimin gjyqësor”. Pra titulli ekzekutiv të jetë lëshuar nga gjykata, sipas neneve 511 dhe 517.

Së dyti, vendosja e hipotekës ligjore apo sekuestrimi, sepse të dyja njëlloj janë, kanë të njëjtin koncept, mbi një pasuri të paluajtshme parashikohet në mënyrë shteruese nga Kodi Civil dhe rrethana e parashikuar nga projektligji i Kryeministrit nuk përfshihet në atë Kod. Si e tillë, shtimi i një rrethane të rremë me ligj, me shumicë të thjeshtë, ndërkohë që në nenet 560, 562 dhe 563 të Kodit Civil nuk e kanë parashikuar, bie ndesh dhe në kundërshtim të hapur me nenin 116 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sipas të cilit: “Një ligj me shumicë të cilësuar nuk mund të ndryshohet me një ligj me shumicë të thjeshtë”.

Së treti, sekuestrimi mbi një pasuri të paluajtshme përbën kufizim të së drejtës së pronës. Pra, të shkosh dhe t’i sekuestrosh qytetarit një apartament që kushton 40 milionë lekë për një faturë 1 milionë e gjysmë lekë, sigurisht do të thotë ta kufizosh atë në të drejtën e pronës. Për këtë arsye ky kufizim duhet t’u nënshtrohet kritereve të parashikuara në nenin 42 të Kushtetutës, duke përfshirë ndjekjen e një procesi të rregullt ligjor. Në nenin 42 të Kushtetutës parashikohet se kufizimi i pronës mund të bëhet, por mund të bëhet vetëm nëpërmjet një procesi ligjor, çka arrin përsëri në të njëjtin rezultat, sekuestroja nuk mund të vendoset nga OSHEE-ja, por vetëm nga gjykata. Çdo veprim i furnizuesit, i OSHEE-së, baras Kryeministri, si subjekt kontraktor, çdo sekuestrim qeveritar, është cenim disproporcional dhe arbitrar i së drejtës së pronës dhe bie në kundërshtim flagrant me Kushtetutën e vendit.

Së katërti, në asnjë rast dhe për asnjë rrethanë cenimi i së drejtës së pronësisë së një personi privat nuk mund të bëhet vetë nga kreditori. Pra, kreditori nuk mund të shkojë të sekuestrojë vetë pasuritë e debitorit, qoftë ky kreditor Kryeministër, qoftë ky kreditor drejtues i OSHEE-së, por vetëm nëpërmjet kontrollit gjyqësor. Qeveria nuk mund të marrë vendim për vendosjen e barrës hipotekore mbi pasuritë e paluajtshme të qytetarëve shqiptarë dhe as të na

kërkojë ne ta autorizojmë OSHEE-në për të sekuestruar pronat e qytetarëve. OSHEE-ja është subjekt juridik, pa asnjë kompetencë më shumë, për të vepruar mbi pronat e shqiptarëve. Çdo detyrim që i jep kësaj shoqërie statusin e kreditorit, duhet të vihet në ekzekutim me mjetet ligjore të parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile, njëlloj siç veprohet me çdo kreditor që pretendon ekzekutimin e një detyrimi në të holla. Nëse kreditorët do të vepronin privatisht për të vënë në ekzekutim detyrime në të holla, atëherë do të ishim para rrezikut të kërcënimit të shtetit ligjor dhe funksionimit të tij sipas parimit të vetëgjyqësisë. Mendoni, sikur t'ia jepnim për të sekuestruar pasuritë e debitorit edhe kompanive celulare, në rast se fatura do të ishte mbi 150 mijë lekë! Ose bankave. Ato e bëjnë, por e bëjnë me kontratë debitori që në fillim. Kështu kemi shtyrjen drejt parimit të vetëgjyqësisë: vendin e ligjit do ta zinin antiligji dhe anarkia. Shteti ligjor do të zëvendësohej me një barbari juridike.

Së fundi, me këtë projektligj, për mua, Kryeministri kërkon të bëhet kryegjykatës dhe kryepërmbarues i vendit e të sekuestrojë pronat e shqiptarëve. Sigurisht, unë nuk mund të jem dakord me këtë projektligj, për aq kohë sa ai bie ndesh të paktën me dy kode të Republikës së Shqipërisë dhe Kushtetutës e vendit.

Jam kundër miratimit të parim, për sa i përket përshtatjes së tij me ligjet e shumicës së cilësuar dhe Kushtetutën e vendit.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Halimi!

Zoti Bylykbashi.

Oerd Bylykbashi – Zoti kryetar, pa i hequr asnjë presje asaj që tha zoti Halimi, për i përket antikushtetutshmërisë së këtij projektligji, duke vendosur kufizime mbi të drejtën e pronësisë, edhe pse me një ligj me shumicë të thjeshtë, i cili vendos rregulla që janë në kundërshtim me një ligj me shumicë të cilësuar, si është Kodi Civil, sigurisht duket qenë i qartë qëllimi që ka Kryeministri në këtë aspekt, gjë që nuk del jashtë kornizës së autoritarizmit dhe abuzivizmit të Kryeministrit në zgjidhjen e problemeve përtej kriterëve themelore që ka shteti i së drejtës. Jemi përpara një paaftësie të Kryeministrit për të zgjidhur problemet me instrumentet që njeht shteti ligjor. Të mos harrojmë se shumë individë, të cilët përdorin kontratat e pronarëve të pasurive të tjera, nuk janë në gjendje të ndryshojnë në kohë procedurat për të ndryshuar kontratën. Për rrjedhojë, pasoja e sekuestrimit, siç e tha zoti Halimi, do të bjerë mbi individë që nuk kanë asnjë lloj përgjegjësie për mospërmbushjen e detyrimit kontraktor nga përdoruesit e sistemit. Konflikti civil nëpër gjykatat e Shqipërisë do të rritet në një masë të paparashikuar.

Një ligj bëhet për të rregulluar problemin dhe jo për ta ngatërruar sistemin më shumë. Ai nuk bëhet për t'a ngatërruar më keq jetën qytetarëve shqiptarë, duke ua bllokuar pronën individëve, shpeshherë të tretë, në raportin mes një kompanie sh.a., private apo shtetërore. I gjithë konceptimi, në një mënyrë amatore dhe aspak profesionale, ka çuar në:

a) thyerjen e parimeve kushtetuese;

b) do të çojë në një rrëmujë dhe konflikt në raportet civile mes palëve, që sistemi gjyqësor nuk e ka për borxh, vetëm se Kryeministri do të zgjidhë një hall në momente të fundit.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Diskutime të tjera?

Ministria për reagim.

Entela Çipa – Do të doja të bëja dy saktësime.

Së pari, kjo e drejtë i jepet vetëm furnizuesit publik, i cili ka detyrimin e shërbimi publik për të furnizuar konsumatorët fundorë, familjarë dhe jofamiljarë, të lidhur në nivelin 1,4 kilovolt.

Së dyti, ky parashikim është bërë në përputhje me Kodin Civil, pasi në nenin 561 të tij jepet e drejta e vendosjes së hipotekës ligjore me kontratë ose me ligj. Ky është një parashikim me ligj të veçantë. Kjo praktikë është zbatuar edhe në ligjin “Për procedurat tatimore”, ku i jepet e drejta administratës tatimore për të mbledhë detyrimin tatimor nëpërmjet sekuestrimit dhe më pas konfiskimit të pasurisë së siguruar në favor të administratës tatimore.

Për nenin 93, pika 5, doja të bëja një saktësim: kompania e ngarkuar me detyrën e shërbimit publik, nuk kryen ekzekutimin e detyrimit. Është përmbaruesi gjyqësor ai që e bën këtë. Te neni 93, pika 5, thuhet: “Përmbaruesi gjyqësor kryen ekzekutimin e detyrimeve nëpërmjet pasurive të tjera. Në rast se nuk i kryen nëpërmjet ekzekutimeve të tjera, atëherë kalon sipas Kodit të Procedurës Civile”.

Fatmir Xhafaj – Zoti Halimi, më falni!

(Diskutim pa mikrofon.)

E bëre diskutimin. Nuk të pengoi njeri. Megjithëse për mua, në pjesën e parë, bëre totalisht një spekulim politik. Në të dytën, pate mendimin tënd profesional, për të cilin mund të mos ndajmë të njëjtin mendim.

(Diskutim pa mikrofon.)

Ka të drejtën e vet ajo.

(Diskutim pa mikrofon.)

Zonja Çipa keni fjalën.

Entela Çipa – Kompania publike njofton Zyrën e Regjistrimit. Është përmbaruesi gjyqësor që i kryen procedurat. Që nga viti 2001 fatura është titull ekzekutiv. I vetmi parashikimi i ri ligjor që vihet është hipoteka ligjore si një masë sigurie për të mos thelluar këtë borxh të madh që i është krijuar kompanisë publike.

Fatmir Xhafaj – A ka diskutime të tjera?

Zoti Manja.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti kryetar!

Nuk do të zgjatem në diskutimin tim në parim lidhur me këtë projektligj, për faktin se jam edhe relator i tij, por dua të bëj një saktësim, më tepër për publikun. Është krejt normale që me çdo projektligj që sjell qeveria në komision, opozita të bëjë politikë, sepse në fund të fundit ky është ky është misioni dhe qëllimi i saj. Para qytetarëve shqiptarë duhet të jemi seriozë, sepse ky projektligj vjen pikërisht për të gjitha ato arsye që ngriti shqetësime kolegu Halimi: pra, për të eliminuar ato anomali serioze që kanë mbizotëruar në sektorin e energjisë.

Interpretime dhe konkluzione të karakterit politik mund të bëhen, por jo interpretime të karakterit juridik, sepse ky është një projektligj që ka një mori dispozitash, të cilat duhen marrë në harmoni me njëra-tjetrën. Nga pikëpamja e arsytimit ligjor dhe të referencave në Kodin e Procedurës Civile dhe Kodin Civil, argumentimi i parafolësit është i gabuar. Të dy kodet nuk lënë shumë hapësira për të bërë interpretime subjektive. Po të shohim në përmbajtje nenin 90, qoftë pikën “d”, qoftë pikën “e”, por edhe nenin 93/5, në harmoni me nenet 510, 511 dhe 527 të Kodit të Procedurës Civile, ky projektligj nuk ka asnjë përplasje të karakterit kushtetues dhe ligjor.

Do të ishte mirë që, kur flitet për nenin 511 të Kodit të Procedurës Civile, duhej t’i ishte referuar nenit 510, një nen më përpara, që tregon se cilët quhen “titujt ekzekutivë”. Në një nga rastet e titujve ekzekutivë, neni 510, pika “e”, thotë: “Ekzekutimi i detyrueshëm mund të bëhet vetëm në bazë të një titulli ekzekutiv”. Përmend rastet se kush janë titujt ekzekutivë. Në pikën “e” thotë “Aktet e tjera, që sipas ligjeve të veçanta, quhen tituj ekzekutivë”. Ngarkohet zyra e përmbarimit për ekzekutimin e tyre. Edhe fatura e energjisë, që ka qenë titull ekzekutiv, do t’i nënshtrohet procedurave standarde që ndjek një ekzekutiv i një titulli ekzekutiv.

Të neni 90 thuhet: “Furnizuesi i energjisë elektrike inicion procedurën e procedimit. Nuk është kompania OSHEE që do të kryejë procedurat e ekzekutimit. Urdhri i ekzekutimit do të lëshohet nga një autoritet gjyqësor. Subjekti i dëmtuar ka të gjitha rrugët gjyqësore për të ankimuar. Mua nuk më duket se nuk është thelbi i diskutimit. Thelbi i projektligjit është vendosja e një rregulli në sektorin e energjisë.

Në fund të fundit, zoti Halimi, në rast se një debutor fundor, familjar, që ka 150 mijë lekë të reja të papaguara, dhe një klient jofamiljar që detyrohet 200 mijë lekë të reja, është krejt normale që kur blen një mall, ta paguash. Nuk është normale që kur qytetarë të ndershëm të këtij vendi paguajnë, ndërsa një pjesë tjetër jo, edhe pse furnizohet për ditë, të tolerojmë. Vetë neni 90 e ka kufizuar në vlerë se kur fillojnë procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm.

Në këtë kuptim, do t'ju ftoja, edhe pse jemi komision për dhënie mendimi, ta diskutojmë deri në fund këtë projektligj, që të japim një produkt të cilin do t'ia përcjellim komisionit përgjegjës.

Fatmir Xhafaj – Zoti Halimi, nuk ka replikë në komision.

Vetëm kur të vemi nen për nen.

Ka diskutime të tjera?

Eduard Halimi – Vetëm dy minuta.

Fatmir Xhafaj – Kalojmë në votimin në parim.

Pro? Kundër? 4. Abstenim?

E mbyllim votimin në parim.

Vazhdojmë nen për nen.

Neni 1.

Zoti Halimi.

Eduard Halimi – Për të sqaruar edhe qytetarët: ka një dallim midis asaj që them unë dhe asaj që thotë kolegu Manja. Dallimi është ky: unë them se sekuestrimin e banesës nuk mund ta bëjë furnizuesi. Sekuestrimin e bën përmbaruesi, Ulsi.

“Furnizuesi ka të drejtë të zbatojë mjetin e sigurimeve të papaguara, duke vendosur barrë hipotekore mbi pasurinë e paluajtshme që furnizohet me energji elektrike”.

Po të lexoj nenin 90.

(Diskutim pa mikrofon.)

Do të lexoj edhe nenin 93.

Cila është logjika e Kryeministrit?

Neni 90 thotë: do të sekuestroj unë, pastaj do t'ia kaloj përmbaruesit, që të vazhdojë procedurat, te neni 93.

Unë them jo. Vetëm gjykata bën veprime mbi pasurinë e qytetarëve. Ky është dallimi midis mendimit tim dhe zotit Manja.

Fatmir Xhafaj – Ka gjë për nenin 1? Nuk ka.

Dakord.

Neni 2. Ka pyetje?

Zoti Bylykbashi.

Oerd Bylykbashi – Nuk shkon kjo, sepse çështja është në themel.

“Qëllimi dhe objekti i ligjit”. Siç tha zoti Manja, ligji është kompleks dhe nenet duhen parë të lidhura me njëra-tjetrën. Ngrita një çështje: ligji nuk bëhet me qëllim apo me objekt për të ngatërruar më keq situatën. Dhashë një shembull pa e specifikuar, por nuk dëgjova asgjë nga përfaqësuesit e ministrisë. Po e shpjegoj më thjeshtë, për qytetarët. Supozojmë se zoti Manja, unë, apo kushdo tjetër, kemi një pasuri që e kemi dhënë me qira, për banesë apo shërbim. Individit që e ka marrë me kontratë qiraje, nuk respekton kushtet. Që të shkosh të ndërrosh kontratën te OSHEE-ja, është një gjë thuajse e pamundur, do të gjendemi në një situatë që, për shkak mospagese të atij që e ka përdorur energjinë elektrike, do të sekuestrohet pasuria. Për çfarë? Për mosrespektim të kontratës nga qiramarrësi.

Pse? Sepse OSHEE-ja ka hall të fusë paratë në xhep, pa bërë të mundur që procedurat të jenë të thjeshta. Ky ligj, përveç problemeve që ka me Kushtetutën, do të bëjë një rrëmujë pa fund. Pronarëve do t’u sekuestrohet pasuria, ngaqë qiramarrësi nuk paguan energjinë elektrike. Kjo do të ishte një dramë e madhe për ta.

Fatmir Xhafaj – Vazhdojmë me nenin 2.

Për nenin 2 ka pyetje?

Eduard Halimi – Neni 2 ka pjesën e përkufizimeve.

Fatmir Xhafaj - Nuk e ka neni 2, por neni 3.

Jeni dakord me nenin 2? Dakord.

Neni 3. Zoti Halimi a keni pyetje?

Eduard Halimi – Ju keni ndërmend që t’i detyroni konsumatorët të lidhin kontratë të re, apo kjo kontratë është e vlefshme? A ka ndonjë efekt ky ligj që do të detyrojë konsumatorët të lidhin kontratë të re?

Fatmir Xhafaj – Fjalën e ka zonja nga ministria.

Entela Çipa – Kontrata sigurisht që është e vlefshme, vazhdon të qëndrojë në fuqi deri në miratimin nga ana e entit rregullator. Kontratë tip e re sipas kushteve të këtij ligji.

Eduard Halimi – Unë jam konsumator dhe kam një kontratë me OSHEE-në për furnizimin e energjisë. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji a do të kem unë detyrimin për të lidhur ndonjë kontratë të re, apo ky ligj nuk ka asnjë efekt mbi kontratën që unë kam me OSHEE-në? Këtë po pyes unë.

Entela Çipa – Kontrata do të qëndrojë në fuqi. Sigurisht është parashikimi për dispozitat transitorë. Të gjitha aktet që nuk bien në kundërshtim me këtë ligj janë në fuqi deri në momentin e miratimit të akteve të reja ligjore dhe në këtë rast është parashikimi për Entin

Rregullator të Energjisë të miratojë modelin e ri të kontratës së rregulluar midis furnizuesit. Por, kontratat janë në fuqi deri në miratimin e akteve të tjera. Të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore që nuk bien në kundërshtim me këtë ligj janë në fuqi.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Jeni dakord me nenin 3? Dakord. Faleminderit!

Miratohet.

Neni 4. “Politikat e sektorit të energjisë elektrike”. Jeni dakord? Faleminderit!

Miratohet.

Neni 5. Jeni dakord?

Ulsi Manja – Për nenin 5 të projektligjit, pika 1 është rënë dakord për një riformulim të këtij neni.

Fatmir Xhafaj – Mund ta lexoni?

Ulsi Manja – Pika 1: “Çdo person fizik ose juridik që prodhon, transmeton, shpërndan, importon, eksporton, ose furnizon energji elektrike është i detyruar të paraqesë pranë ministrisë përgjegjëse për energjinë të dhëna lidhur me veprimtarinë e tij, me qëllim zhvillimin e politikave të zhvillimit të sektorit energjetik dhe komunikimin me institucionet e specializuara në kuadrin e angazhimeve ndërkombëtare të Shqipërisë, si dhe përgatitjen dhe publikimin e bilancit vjetor energjetik”. Pra, është një riformulim në aspektin e teknikës legjislativë.

Fatmir Xhafaj – Jeni dakord me ndryshimin, propozimin?

Entela Çipa – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Kur ka ndryshime, duhet të jepni dakordësinë. Në rast se nuk e jepni, atëherë do të ketë debat, pastaj vendos komisioni. Në qoftë se ju bini dakord, prandaj mbron qeverinë këtu.

Neni 6. Jeni dakord? Dakord.

Neni 7. Jeni dakord? Dakord.

Ulsi Manja – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Neni 8. Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi- Te neni 8, paragrafi 2, pika “ç” është problem i teknikës legjislativë. Duhet hequr shprehja si për shembull “sistemet e avancuara të matjes” etj. Por duhet lënë thjesht: “nxitjen e përdorimit të teknologjisë së menaxhimit në kohë reale të kërkesës”.

Fatmir Xhafaj – Jemi dakord me vërejtjen.

Neni 9. Jeni dakord? Dakord.

Neni 10: “Pavarësia e ERE-s”. Jeni dakord? Dakord.

Neni 11: “Zgjedhja dhe emërimi i anëtarëve të bordit”.

Po, zoti Manja.

Ulsi Manja – Ne kemi bërë një riformulim të nenit 11. Po te neni 11 duhet zgjidhur problemi i përfaqësuesve të bordit pasi në projektligj, në këtë nen, thuhet se ekipi përbëhet nga dy përfaqësues të zgjedhur nga Kuvendi i Shqipërisë, pikërisht kryetari i komisionit përgjegjës për energjinë dhe Kryetari i Komisionit përgjegjës për Ekonominë dhe anëtari i tretë i bordit nuk është përcaktuar nga do të jetë anëtar i tretë i bordit. Pra, bordi do të ngelet me dy përfaqësues.

Fatmir Xhafaj - Po, zoti Bregasi.

Agim Bregasi - Ndryshimi me ligjin ekzistues është që është hequr ministri përgjegjës i energjisë si përfaqësuesi i qeverisë. Pra, rritet pavarësia e bordit.

Entela Çipa – Këtu ka qenë dhe një rekomandim nga ana e sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për rritjen e pavarësisë në përzgjedhjen e anëtarëve të bordit të ERE-s. Ministri të mos jetë pjesë e ekipit përzgjedhës, por thjesht të bëjë propozimet.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Ka pyetje dhe sugjerime? Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Pyetja ime kishte të bënte pikërisht me pikën 2 të këtij neni, kur flitet për ekipin përzgjedhës të komisionerëve. Deri më sot kuptova që e bënte ministri. Ndërkohë ia lini dy përfaqësuesve të komisioneve përkatëse që gjithmonë në çdo parlament i përkasin kryesisht maxhorancës. Këto janë dy institucione shumë të rëndësishme, komisionit që i përkasin maxhorancës. A ka ndonjë rekomandim se si duhet përzgjedhur bordi?

Fatmir Xhafaj – Nga e do rekomandimin, zonja Vasilika? Nga OSBE-ja?

Vasilika Hysi – Jo, në kuadër të stabilizim-asociimit kapitulli është i veçantë dhe ka një pikë të veçantë për mënyrën e përzgjedhjes së bordeve në Republikën e Shqipërisë.

Fatmir Xhafaj – Keni ndonjë rekomandim për këtë gjë?

Entela Çipa – Nga komisioni përgjegjës i Veprimtarive Prodhuese është paraqitur propozimi, si dhe nga sekretariati, që në momentin që vendi mbetet vakant, të bëhet publikimi nga ana e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Pra, është shtuar dhe ky parashikim.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Zoti Halimi.

Eduart Halimi – Meqë kemi një ligj të ri për zgjedhjen e personave që do të hyjnë në zyrat e shtetit unë mendoj se është vendi që të vendosim dhe një kriter shumë të rëndësishëm, kriteri i dekriminalizimit. Pra, të vendosim një nen i cili të përcaktojë se anëtar bordi nuk mjafton vetëm të kesh 10 vjet eksperiencë pune në energjinë elektrike apo 10 vjet si jurist, por

të vendoset një nen tjetër, se kemi pasur dhe raste ku kandidatët të mos kenë të shkuar kriminale, pra të mos jenë dënuar për kryerjen e një krimi nga gjykatat shqiptare, apo të mos jenë në kërkim nga agjencitë e zbatimit të ligjit ndërkombëtar.

Fatmir Xhafaj – Ka tjetër për të folur? Nuk ka.

Kush është dakord me nenin 11, siç është? Dakord. Faleminderit!

Miratohet.

Neni 12: “Shkarkimi dhe lirimi nga detyra i anëtarëve të bordit”.

Po, zoti Halimi.

Eduard Halimi – Në të njëjtën linjë unë mendoj se e pashë vullnetin e madh për dekriminalizimin!

Fatmir Xhafaj – Kur ta mbarojë punën komisioni.

Eduard Halimi – Pse do të presim? Ju kaloni ligjin.

Fatmir Xhafaj – Doni t’i lini punën nën rrota zotit Bylykbashi!

Eduard Halimi – Do të futemi prapë këtu ne?

Fatmir Xhafaj – E keni gabim. Duhet të ndryshoni Kushtetutën. I dini ju ca gjëra!

Eduard Halimi – Zoti Xhafaj, e kam për ata që kanë poste dhe tani për ata që do të marrin poste publike. Tani themi se ai që do të marrë një post publik duhet të ketë figurën e pastër. Në nenin 12 unë gjykoj se duhet futur përsëri. E para, pika 2, edhe nga ana e teknikës legislative duhet të ndryshohet se bëhet ose kandidon për t’u bërë deputet, se nuk shkon asnjë fjali nga ana e teknikës linguistike, por duhet të jetë: “kandidon ose zgjidhet deputet në Kuvendin e Shqipërisë. Kandidon ose zgjidhet përfaqësues në organet e qeverisë vendore, se duhet të jetë shkruar gabim. Është i paaftë për të përmbushur detyrimet e përgjegjësisë së ERE-s”. Dhe pas pikës “ç” të shtohet pika “d”: “rezulton i dënuar për kryerjen e një krimi nga gjykatat shqiptare, ose rezulton i kërkuar nga agjencitë ndërkombëtare të zbatimit të ligjit”.

Fatmir Xhafaj – Po, zoti Manja.

Ulsi Manja – Për nenin 12, së bashku me përfaqësuesit e qeverisë, kemi rënë dakord për një riformulim i cili merr në konsideratë të gjitha ndërhyrjet e teknikës legislative. Në thelb ngelet po ai nen, por ka riformulim të karakterit teknik.

Fatmir Xhafaj – Dakord. E keni në ligj ju se dënohet për kryerjen e një vepre penale me vendim të gjykatës së formës së prerë? Vendim gjykate?

Ulsi Manja – Po. Si dhe është shtuar dhe një pikë “c” te pika 1 e nenit 12, kur vepron në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit! Jam dakord dhe me ndërhyrjen e teknikës legislative të zotit Halimi, kandidon ose zgjidhet. Se bëhet pastaj kandidon. Vetëm ju mund ta keni bërë

këtë. Zoti Halimi ka të drejtë. Por unë kam një gjë këtu. Po në qoftë se ai kandidon për anëtar i këshillit në mënyrë të pavarur, çfarë problemi ka dhe nuk zgjidhet? Zonjë, pasi bëhet ose kandidon nuk ka. Deputeti ka të drejtë. Kandidon ose zgjidhet ka dhe logjikë. Doni të kundërshtoni për çdo gjë apo e ke për forcë!

Entela Çipa – Kemi rënë dakord.

Fatmir Xhafaj – Unë kuptoj se kandidon ai si për anëtar këshilli. Çfarë problemi ka që të jetë anëtar i bordit, se nuk e kuptoj. Jam kandidat i pavarur nuk zgjidhem, por do të rri anëtar bordi. Çfarë pengese ka?

Entela Çipa – Kështu është menduar, sepse aty është një institucion me kohë të plotë. Ka një impenjim më të madh dhe nuk mund të mbrosh interesat të sektorit...

Fatmir Xhafaj – Nuk më pengon nga koha. Unë mbroj interesat e qytetarëve në atë zonën atje, ju thoni jo.

Dakord.

Keni gjë për nenin 12, veç ndryshimeve të propozuara?

Dakord. Miratohet neni 12 me ndryshimet e paraqitura.

Neni 13: “Kryetari i bordit”.

Në nenin 2 në rast se kryetari mungon për një periudhë të caktuar kohe, por jo më shumë se 1 muaj, nuk caktohet njeri tjetër? Po të mungojë më pak? Ligji, zonjë, thotë jo më shumë se 1 muaj. E keni jo më pak se 1 muaj.

Entela Çipa – Atëherë caktohet një nga anëtarët e bordit që të ushtrojë përkohësisht funksionet...

Fatmir Xhafaj – Po, pra më pak. 15 ditë cakton një tjetër. Po kur mungon më shumë se 1 muaj çfarë bëhet?

Entela Çipa – Në rastet kur mungon më shumë se...

Fatmir Xhafaj – Neni 13 është për në fund, pra shtyhet.

Neni 14. “Personeli teknik dhe këshilltarët”.

Jeni dakord? Dakord.

Neni 15. “Konflikti i interesit”.

Po, zoti Halimi.

Eduard Halimi – Në fakt i gjithë neni për konfliktin e interesit duhet të përshtatet me ligjin “Për konfliktin e interesit”, sepse nuk mjafton vetëm që anëtari i bordit personalisht të jetë pronar-aksioner zotërues, por duhet të jenë dhe personat e lidhur me të. Pra, mund të jetë vëllai po them unë aksioner dhe ky është anëtar bordi. Ligji “Për konfliktin e interesit” e ka shumë neni 72, në mos gaboj.

Fatmir Xhafaj – Keni ndonjë propozim apo doni ta rishihni më mbrapa?

Eduard Halimi – Pra, neni 15 siç është të përshtatet me ligjin “Për konfliktin e interesit”.

Fatmir Xhafaj – Ta shtyjme atëherë.

Eduard Halimi – Të shtyhet.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Zonja Hysi jeni në të njëjtën linjë?

Vasilika Hysi – Të njëjtin mendim kisha, por kam dhe një pyetje.

Te pika “d”, kur thotë të ketë interes material në sektorin e energjisë, çfarë do të kuptoni, se e keni lënë shumë të gjerë?

Entela Çipa – Gjatë diskutimeve në Komisionin e Veprimtarive Prodhuese është riformuluar neni 15.

Fatmir Xhafaj – Jemi te Komisioni i Ligjeve, jo te Komisioni i Veprimtarive Prodhuese. Ai që e drejton komisionin quhet Eduard Shalsi.

Entela Çipa – Është ripunuar, është marrë në konsideratë dhe ligji “Për konfliktin e interesit”.

Fatmir Xhafaj – Jepini përgjigje zonjës, se zonja nuk ka qenë atje. Mos u lodhni zonjë. Ne nuk lodhemi ne këtu. Ti paguhesh për atë punë. Ne këtu kemi durim dhe nuk mërzitemi!

Entela Çipa – Jemi dakord.

Fatmir Xhafaj - Për çfarë jeni dakord?

Entela Çipa – Jemi dakord për parashikimet sipas ligjit “Për konfliktin e interesit”.

Fatmir Xhafaj – Na sillni një riformulim ta shohim, se nuk mund të jemi ne dakord me dakordësinë tuaj. Kjo është përgjigjja.

Shtyhet dhe neni 13 dhe 15 për t’u risjellë një formulim i tij.

Neni 16: “Mbledhjet dhe vendimet e bordit të komisionerëve”.

Ulsi Manja – Për nenin 16, pika 2 fjalía “në rast të votave të barabarta, vota e kryetarit është përcaktuese” të hiqet, pasi është parashikuar në ligjin “Për funksionimin e organeve kolegjiale dhe riformulohet si më poshtë:

“Mbledhjet e bordit zhvillohen me pjesëmarrjen e jo më pak se 3 anëtarëve dhe vendimet merren me shumicën e të gjithë anëtarëve të bordit”.

Entela Çipa – Dakord.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Neni 17: “Financimi i ERE-s”. Dakord?

Dakord.

Eduard Halimi -Se marrja e kredisë nuk mund të bëhet. Mirë që po i menaxhojmë vetë, do përcaktojmë dhe pagat vetë, do të marrë dhe kredi vetë. Në qoftë se marrin kredi ata miliona e miliona kush do t'i paguajë pastaj? Nuk mund të marrin kredi ata pa miratim. Nuk ka Kushtetuta përcaktim. Askush nuk mund të marrë kredi pa miratimin e autoriteteve. Dhe Ministria e Financave nuk mund të marrë kredi.

Entela Çipa – Ka qenë ky parashikim në ligjin që është në fuqi dhe kemi menduar ta lëmë si një rast emergjente. Nuk është aplikuar deri më sot. Mund të parashikohen raste kur pagesa rregullatore nuk mjafton dhe ka qenë si parashikim. E kanë entet e tjera rregullatore. Duke qenë institucione të pavarura kemi menduar ta lëmë. Mund dhe të riformulohet.

Buxheti i ERE-s paraqitet në Kuvend dhe miratohet nga ky parlament, kështu që kjo do të jetë pjesë...

Së bashku me raportin vjetor paraqitet dhe buxheti çdo vit.

Fatmir Xhafaj – Neni 17 riformulim.

Neni 18: “Objektivat e përgjithshme të ERE-s”. Jeni dakord? Faleminderit!

Neni 19: “Përgjegjësitë”.

Po.

Ulsi Manja – Për nenin 19 ne sugjerojmë që pika e dytë e tij të dalë si nen më vete dhe të titullohet: “të drejtat e ERE-s”, pasi është një nen goxha i gjatë dhe pika 2 e nenit 19 të dalë si nen më vete.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Neni 19/1.

Po, zoti Halimi.

Eduard Halimi- Kam një shqetësim këtu te ky nen, por ma thoni nëse është implementuar ndonjë nen tjetër dhe të mos ngul këmbë kot këtu. Këtu ERE, sipas këtij neni, monitoron zbatimin e kontratave, monitoron dhe kontrollon furnizuesit, konsumatorët. Ka vetëm të drejta. Ka ndonjë nen me detyrimet e ERE-s? Ka ndonjë nen dhe më poshtë që të përcaktojë që mirë kur vjen energjia në rregull dhe konsumatorët janë të kënaqur, po kur energjia vjen e ulët dhe konsumatorët dëmtohen, a ka ndonjë nen aty që ERE ka detyrime që t'i paguajë këtyre konsumatorëve? Mos është ndonjë nen tjetër. Se këtu kemi vetëm të drejtat. Po detyrimet, se gjithmonë ato shkojnë bashkë.

Entela Çipa – Nga parashikimet për të cilat ka të drejta ERE ka edhe detyrimin për të vendosur sanksione ndaj pjesëmarrësve të tregut. Nuk është ERE ajo që dëmshpërblen konsumatorët, por vendos, parashikon sanksionet në të gjitha aktet e veta rregullatore që miraton.

Fatmir Xhafaj – Duhet të jetë te furnizuesja, ajo besoj.

Entela Çipa – Për furnizimin për të gjithë pjesëmarrësit e tregut ka sanksione. Ky është një kapitull i veçantë.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Unë kisha të njëjtin propozim me relatorin. Është nen i gjatë. Ndoshta është brenda nenit 19, por mund të ketë një sistemim të radhës. Para se të thuhet për bashkëpunimin jepen përgjegjësitë, kompetencat bazë dhe bashkëpunimi në përgjithësi shkon më pas. Pra, te renditja e paragrafëve. Se ka një çoroditje të këtyre kompetencave.

Fatmir Xhafaj – Neni 19 ndahet në dy nene. Dakord.

Neni 20? Jeni dakord? Dakord. Faleminderit!

Neni 21: “Monitorimi nga ERE”.

Eduard Halimi – Te neni 20 tarifat e aplikueshme të zbatohen në mënyrë jo diskriminuese. Kjo është vetëm deklarative. Si do të bëhet kjo në ligj se në ligj e keni.

Fatmir Xhafaj – Po, zonja Çipa.

Entela Çipa - ERE miraton metodologjitë e llogaritjes së tarifave për të gjithë ata që ofrojnë shërbime të rregulluara. Dhe këtu një nga parimet themelore është mosdiskriminimi dhe parimi i transparencës. Ka kosto të drejtë, të llogaritur, ka parashikime të veçanta lidhur me kostot.

Fatmir Xhafaj – Po, zonja Hysi për nenin 21.

Vasilika Hysi – Unë te neni 21 kam një shqetësim lidhur me titullin e dispozitës, monitorimin nga ERE dhe fillimin e paragrafit të parë, ku thuhet se ERE veç të tjerave monitoron.

Para së gjithash unë sugjeroj që në ligj duhet të thuhet një herë fushat e monitorimit, ku monitoron ERE dhe pastaj mund të kesh këto përjashtime. Pra, si formulimi i titullit, edhe paragrafi i parë mendoj se ka nevojë të rishikohen.

Fatmir Xhafaj – Po, faleminderit!

Relatori?

Ulsi Manja – Edhe në mbështetje të koleges Hysi, ne kemi rënë dakord që formulimi i dispozitës të mos nisë me “ERE monitoron, veç të tjerave”. Fjalët “veç të tjerave” duhet të hiqen. Ose të na thuash çfarë nënkupton “ERE monitoron, veç të tjerave”. Prandaj ne kemi rënë dakord që të hiqet pjesa “veç të tjerave” dhe të fillojë: Monitorimi nga ERE, dhe ERE monitoron, dy pika. Aty të fillojë të specifikohen.

Entela Çipa – Jemi dakord me riformulimin nga ana e teknikës legjislative, por do të doja të bëja një sqarim. Ngaqë është ndjekur në përputhje me direktivën, ata përdorin gjuhë tjetër dhe nuk i kanë shteruese të gjitha veprimtaritë.

Fatmir Xhafaj – Por mund ta vendosësh në fund.

Entela Çipa – Për teknikën tonë legjislative jemi dakord.

Fatmir Xhafaj – Ata e kanë ndryshe teknikën? Dakord!

Neni 21, me sugjerimin e bërë, kalon.

Neni 22? Faleminderit!

Neni 23?

Neni 24? Dakord?

Më falni, këtu, ERE vetëm një herë në vit mund të raportojë?

Entela Çipa – Raporton para Kuvendit një herë në vit, ndërsa është parashikuar që çdo katër muaj të publikojë të dhëna lidhur me ecurinë e tregut. Vetëm para Kuvendit raporton një herë në vit.

Fatmir Xhafaj – Po nëse ka diçka Kuvendi apo Komisioni që është përgjegjës?

Entela Çipa – Në bazë të diskutimit që kemi bërë me komisionin përgjegjës, mendoj se është rregullorja juaj e Kuvendit – sepse është ngritur ky shqetësim dhe nga pjesëmarrësit e tjerë – që mund ta rregullojë për organet e pavarura dhe sa herë e kërkon.

Fatmir Xhafaj – Sa herë që kërkohet dhe kaq. Dakord!

Pjesa e pestë: dispozita të sistemit, seksioni i parë, neni 25: “Funksionimi i integruar i sistemit të energjisë”. Dakord?

Neni 26: “Lidhja me rrjetin”. Dakord.

Neni 27: “Kostot për lidhjen me rrjetin”. Po?

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar! Kam një pyetje në lidhje me paragrafin e parë. Ju thoni që kostoja e plotë për lidhjen me rrjetin mbulohet nga pala që kërkon lidhjen në rrjet. Ç’kuptoni me “kosto të plotë”, sepse më poshtë thoni: “kostot e lidhjes”? Ka dallime?

Entela Çipa – Është menduar “kosto e plotë”, pasi “kosto e drejtë” mund të linte nënkuptime dhe në këtë mënyrë është parashikuar vetëm kostoja reale, që përdoruesi i rrjetit ka realizuar për lidhjen e re. Pra, jo shpërblime e të drejta të tjera që mund të sigurojnë. Pra, kostoja e plotë e lidhjes së rrjetit.

Fatmir Xhafaj – Po.

Vasilika Hysi – Atëherë, zoti kryetar, sugjeroj që te kostoja e plotë të jetë e qartë për çdo qytetar klient, që të dijë se çfarë përfshihet në koston e plotë. Se mund të përfshihen edhe të gjithë linjat e shtrirjes, apo jo, përveç sahateve, matësve. Duhet të jetë më e qartë. Pra, të

mos këtë abuzime në koston ë duhet të paguajë një klient që do të lidhet në rrjet. Në dijeninë time, ne deri më sot paguajmë vetëm matësin, që është 250 mijë lek të vjetra, apo jo? Apo tani do të fusni edhe tubat, edhe gjeneratorët e të tjera?

Fatmir Xhafaj – Po e keqkuptoni gjithë këtë histori.

Zoti Bregasi, na e sqaro një çikë teknikisht, të lutem! Ne konsumojmë energji, por nuk jemi ekspertë.

Agim Bregasi – Çdo lidhje e re, në zhargonin popullor është ashtu siç e shpjegoi zonja Hysi, por në fakt, sa i takon lidhjes së re, janë tri tarifa që përcaktojnë detyrimin e konsumatorit për lidhjen e matësit, por jo matësin vetë, sepse është pronë e shoqërisë. Në qoftë se ka nevojë për fuqizimin e rrjetit nga banesa deri te shtylla, në qoftë se ka nevojë nga shtylla ose rrjeti kabllor deri në kabinë, dhe fuqizimi në kabinë, në qoftë se konsumatori është shumë i madh dhe nuk e përballon.

Pra, këto janë tarifat dhe ka një rregullore të veçantë, mbështetur mbi metodologjinë që përcaktohet se kush janë tarifat.

(Diskutime pa mikrofon)

Në qoftë se është një konsumator – po e bëjmë një çikë ekstrem që të kuptohet më mirë – i madh dhe linja që vjen nga kabina e deri aty nuk e përballon këtë energji, këtë fuqi, atëherë konsumatori, kur është konsumator shumë i madh – nuk flitet për familjarët, se familjarët e kanë të limituar, pra jo familjarët janë të detyruar të paguajnë edhe tarifën e zëvendësimit të përcjellësit ajror apo të kabullit, për të përballuar edhe këtë energji. Pra, nuk shkon në koston e shoqërisë. Kurse për ata që hyjnë në rrjet si prodhues, pra për hidrocentralet, ai është i detyruar të përballojë gjithë koston nga hidrocentrali deri në pikën e lidhjes.

(Diskutime pa mikrofon)

Është metodologjia. Kostot i përballon ai. Pastaj, në metodologji.

Entela Çipa – Bazuar në metodologjinë, thotë ligji që do të miratohet nga enti rregullator.

Agim Bregasi – Do të vijnë dhe shumë gjëra të detajuara, jo kaq kabull, jo kaq kështu apo ashtu. Këto janë të përcaktuara.

(Diskutime pa mikrofon)

Entela Çipa – Është shumë e detajuar metodologjia që miratohet nga ERE dhe i ka të ndara kategoritë; për konsumatorë familjarë, jo familjarë, sipas nivelit të tensionit, për prodhues, për klientë fundorë. Pra, është shumë e detajuar.

Agim Bregasi – Zoti kryetar, te pika 3 është kjo ë sugjerohet nga ana juaj. Në llogaritjen e pagesës në lidhje, merren në konsideratë pika e lidhjes, kapaciteti i saj, qëllimi i synuar dhe modeli i konsumit, ndonjë kërkesë e veçantë, statusi.

(Diskutime pa mikrofon)

Kërkesa të veçanta. E bëjmë “kërkesa të veçanta.

(Diskutime pa mikrofon)

Po pra. kërkesa të veçanta ose statusi i përdoruesit të rrjetit, si dhe karakteristikat e pikës së lidhjes.

(Diskutime pa mikrofon)

(Ndërprerje e shkurtër incizimi)

Për familjarët është ndryshe, për trefazorët është ndryshe. Pra është më e lehtë për familjarin. Kostoja e një lidhjeje të re është më e ulët se sa për të lidhur një konsumator industrial.

Entela Çipa – Domethënë varet nga fuqia, nga distanca. Janë shumë faktorë që mundësojnë përcaktimin e tarifës së lidhjes.

(Diskutime pa mikrofon)

Agim Bregasi – Zoti kryetar, po të shikojmë, edhe te pika 4 ka një detajim të mjaftueshëm për ligjin.

(Diskutime pa mikrofon)

E shohim, por edhe katra, le të themi, e specifikon.

(Ndërprerje e shkurtër incizimi)

Fatmir Xhafaj – Neni 29. Nuk kemi gjë për interkonjeksionin.

Neni 30: “Interkonjektorët e rinj me rrymë të vazhduar”. Dakord.

Neni 31: “Linja direkte”. Dakord.

Neni 32. Dakord.

Neni 33: “Ndarja e llogarive të shoqërive të sektorit elektrik”. Dakord.

Neni 34: “Zonat e mbrojtura dhe të sigurisë”. Dakord.

Seksioni i dytë: “Licencimi”.

Neni 35: “Veprimtaritë e licencuara dhe përjashtimet”. Dakord.

Neni 36: “Procedurat e licencimit”. Dakord.

Neni 37: “Kushtet e licencimit”. Dakord.

Neni 38: “Njoftimi për aplikimet për licencë”. Dakord.

Neni 39: “Refuzimi i një licence”.

Ulsi Manja – Në lidhje me nenin 39, kemi rënë dakord për riformulimin e këtij neni.

Fatmir Xhafaj – Po. Ku konsiston?

Ulsi Manja – Neni 39 riformulohet si më poshtë:

pika 1 ndahet në germa a, b, c. Pra: ERE e refuzon dhënien e licencës, nëse aplikuesi, dy pika, dhe i kemi përcaktuar me germat a, b dhe c. Ka një riformulim po të pikës 2 të këtij neni. Thjesht janë riformulime të karakterit të teknikës legjislativë, por në thelb nuk e ndryshojnë përmbajtjen e neni. Nëse është e nevojshme mund ta lexoj riformulimin.

Fatmir Xhafaj – Në rregull! Dakord! Faleminderit!

Neni 40: “Heqja e një licence”. Dakord?

Neni 41: “Modifikimi i kushteve të licencës”. Dakord?

Ulsi Manja – Edhe për nenin 41 ka një riformulim. Është riformulim i karakterit të teknikës legjislativë, që e ngushtojnë hapsirën e neni, por nuk e prekin thelbin e tij. Është rënë dakord me palën e Ministrisë.

Fatmir Xhafaj – Dakord, Ministria?

Neni 42. Dakord.

Neni 43. Dakord.

Neni 44. Dakord.

Neni 45. Dakord.

Neni 46. Dakord.

Neni 47. Dakord.

Neni 48. Dakord.

Neni 49. Dakord.

Ulsi Manja – Për nenin 49, sugjerojmë të ndahet në dy nene. Në nenin 49: “Të drejtat e prodhuesit” dhe në nenin 49/1: “Detyrimet e prodhuesit”. Pra, të ndahen të drejtat në një nen më vete, dhe detyrimet në një nen më vete.

Dakord. Faleminderit!

Miratohet me ndryshimin.

Neni 50. Dakord.

Seksioni i katërt: “transmetimi i energjisë elektrike.

Neni 51: “Operatori i sistemit të transmetimit”. OST-ja e famshme, po? dakord me nenin 51?

Ulsi Manja – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Më fal, përse duhet të ketë licencë të re për OST-në, zoti Bregasi? Zonja Çipa?

Entela Çipa – Parashikohet certifikimi i OST-së – është kërkesë e direktivës – dhe mbi bazën e këtij certifikimi, që do të kryhet nga enti rregullator, do të jepet licenca e re. Ky është një kusht për përputhshmërinë me direktivën.

Fatmir Xhafaj – Po deri tani, si ia keni bërë?

Entela Çipa – Nuk ka qenë i parashikuar certifikimi.

Agim Bregasi – Deri tani kanë qenë operatorët në treg, por direktiva parashikon certifikimin, në mënyrë që të rrisë edhe cilësinë dhe përgjegjësitë e operatorit të sistemit të transmetimit, në përputhje me direktivën. Pra, ne kemi kaluar, ose në detyrim të MSA-së dhe Traktatit të Energjisë, por edhe të anëtarësimit të TSO – së në ENZO, vetë operatori i sistemit të transmetimit duhet të ketë cilësisht disa dallime, dhe një nga këto është certifikimi. Pra, të mos jetë thjesht një OST që çon energji këtu e atje, por të ketë disa kushte që ta marrë këtë certifikatë.

Fatmir Xhafaj – Neni 52: “Ndarja e pronësisë”. Dakord.

(Ndërprerje e shkurtër incizimi)

Ju kërkoj të falur.

Neni 52. Dakord.

Zoti Manja, po, neni 53: “Të drejtat e operatorit”.

Neni 54: “Detyrat e operatorit”

Ulsi Manja – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

(Diskutime pa mikrofon)

Neni 55: “Certifikimi”

Ulsi Manja – Dakord.

Vasilika Hysi – Kam një pyetje. Ju thoni te titulli: “Caktimi dhe certifikimi i operatorit të sistemit të transmetimit”, dhe në përmbajtjen e nenit flisni vetëm për certifikim. Ç’kuptoni me “caktim”? Për çfarë e keni fjalën? Faleminderit!

Entela Çipa – Ky është edhe parashikimi i ri i direktivës. Pra, caktohet si OST, megjithëse ne vetëm një OST kemi dhe ajo do të caktohet, por është pjesë e direktivës.

(Diskutime pa mikrofon)

Përcaktohet në fillim se kush do ta kryejë, dhe ajo do të certifikohet.

(Diskutime pa mikrofon)

Do të miratojë rregulloren, se si do të caktohet e do të certifikohet.

(Diskutime pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Bën certifikimin.

Vasilika Hysi – Tek titulli ka caktim dhe certifikim. ERE i bën të dyja, edhe caktimin, edhe certifikimin? Është thënë ndokund në ligj se i bën? Se mos bie në konflikt interesi, që edhe e cakton, edhe e certifikon.

Entela Çipa – Do të marrim një vendim në lidhje me certifikimin. Mund të shtohet dhe fjala “caktim” aty, por kemi menduar që në rregulloren që do të miratojë ERE për këtë qëllim...

(Diskutime pa mikrofon)

Dakord.

Fatmir Xhafaj – Në rregull.

Çfarë cakton, zonja Çipa?

Entela Çipa – Cakton se cili do të jetë organi që do t'i kryejë, pra kompaninë, operatorin e sistemit.

Fatmir Xhafaj – Këto janë pjesë e procedurës së certifikimit. Pse e zgjat shumë? Certifikimi i operatorit të sistemit. Pastaj aty futen kriteret. Është procedura. Mund të thuhet, po deshët ju: procedura e certifikimit të operatorit të sistemit. Dhe i përmbledh brenda. Por më e mira është: certifikimi i operatorit të sistemit. Aty janë brenda. Edhe zonja Hysi e pranon këtë zgjidhje. Dakord? faleminderit.

Te titulli: neni 56, vetëm kaq. Neni 56. Dakord?

Neni 57. Dakord?

Ulsi Manja – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Neni 58. Dakord?

Ulsi Manja – Dakord.

Neni 59. Dakord?

Ulsi Manja – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Neni 60. Dakord?

Ulsi Manja – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Neni 81. Dakord?

Ulsi Manja – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Neni 62. Dakord?

Ulsi Manja – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Neni 63. Dakord?

Ulsi Manja – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Neni 64: “Shpërndarja e energjisë elektrik”, sesioni i pestë. Dakord?

Ulsi Manja – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Kjo është OSSHE-ja, apo jo?

(Diskutime pa mikrofon)

Emri varet nga ministri, nga Kryeministri i radhës, si iu duket më bukur.

Neni 65. Dakord?

Ulsi Manja – Te neni 65, propozojmë që fjalia e parë të riformulohet: “Operatori i sistemit të shpërndarjes ka këto detyra”. Pra, të shtohen fjalët: “ka këto detyra”.

Vasilika Hysi – Lidhur me nenin 65, te pika 5, ju thoni: “u siguron përdoruesve të rrjetit informacionin e arsyeshëm e të nevojshëm”. Ç’do ët thotë kjo “informacionin e arsyeshëm për akses”? Ai mund të jetë i arsyeshëm për ju, por ndoshta për qytetarin është e pamjaftueshme. Mos duhet bërë informacioni ashtu siç duhet? Sepse ne e kemi problem, si përdorues të rrjetit.

Agim Bregasi – Pra, te shpërndarja ka dy nocione.

(Diskutime pa mikrofon)

Zonja Hysi, ka dy pjesë, ka rrjetin shpërndarës dhe furnizuesin. te rrjeti shpërndarës përfshihet fuqia, trashësia e telit, sa është kjo e sa është ajo, domethënë ka të dhëna teknike të rrjetit. Pra, këto i vihen në dispozicion.

(Diskutime pa mikrofon)

Entela Çipa – Informacionin e nevojshëm. Po, dakord.

(Diskutime pa mikrofon)

Dakord. në vend të “arsyeshëm”, “të nevojshëm”.

Me nenin 65, dakord me ndryshimin.

Neni 66.

Ulsi Manja – Dakord.

(Diskutime pa mikrofon)

Vasilika Hysi – Kam një sugjerim unë. Te titulli ju përdorni shumë fjalë të huaja. Keni vendosur të përdorni fjalë të huaja?

Fatmir Xhafaj – Po si ta kthesh në shqip? Mbase e kanë pasur të vështirë.

Vasilika Hysi – Hiqeni atëherë.

(Diskutime pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Po Mirë, dakord.

Po. Faleminderit.

Neni 67. Dakord.

Neni 68. Dakord.

Neni 69: “Kodi i shpërndarjes.” Dakord?

Ulsi Manja – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Neni 70. Dakord?

Ulsi Manja – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Neni 71. Dakord?

Ulsi Manja – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Neni 72. “Matja e energjisë elektrike”. Dakord?

Ulsi Manja – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Neni 73. “Kontrolli i matësve”. Dakord?

Ulsi Manja – Dakord.

Fatmir Xhafaj – neni 74. “Sistemet matëse inteligjente”. Dakord?

Ulsi Manja – Dakord. Kjo është risi.

Fatmir Xhafaj – Kjo është risia juaj?

Ulsi Manja – Po.

Fatmir Xhafaj – Ky është vetë...

(Ndërprerje e shkurtër incizimi)

(Diskutime pa mikrofon)

Entela Çipa – ...edhe ne, në kuadrin e traktatit, që të bëjmë një plan dhjetëvjeçar për implementimin e tyre.

(Diskutime pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj - Neni 75, dakord?

Entela Çipa - Dakord.

Fatmir Xhafaj - Neni 76, dakord?

Entela Çipa - Dakord.

Fatmir Xhafaj - Neni 77, dakord?

Vasilika Hysi - Neni 77, jo. Është kontrata jonë, e qytetarëve.

Zoti kryetar, neni 77 është neni më i rëndësishëm, është kontrata e furnizimit me energji elektrike e të gjithë klientëve. Në pikën 4 thuhet: “përpara lidhjes së kontratës, klientëve duhet t’u sigurohet informacion i përgjithshëm”.

Jo, klientëve duhet t’u sigurohet një informacion i detajuar dhe transparent për kushtet e furnizimit të kontratës për t’u dhënë fund njëherë e përgjithmonë problemeve që ne kemi sot me furnizimin e energjisë elektrike, me djegien e pajisjeve, dhe që nuk përfitojmë asgjë. Kontratat që janë sot nuk i keni bërë ju, janë të famshmet, janë të pakuptueshme dhe diskriminuese për qytetarët. Prandaj informacioni duhet të jetë i detajuar dhe transparent. Duhet t’u jepet kohë e mjaftueshme qytetarëve për t’u konsultuar me kontratën.

Fatmir Xhafaj - Si është formulimi juaj?

Vasilika Hysi - Jo i përgjithshëm.

Fatmir Xhafaj - Dakord. Heqim fjalën “i përgjithshëm”.

Vasilika Hysi - Pra, përpara lidhjes së kontratës, klientëve duhet t’u sigurohet një informacion i detajuar dhe transparent me shkrim për kushtet e kontratës. Duhet t’u lëmë kohë për t’u konsultuar.

Fatmir Xhafaj - Dakord.

Vasilika Hysi - Se keni futur dhe heshtjen, jo për gjë.

Fatmir Xhafaj - Keni gjë tjetër? Nuk keni.

Ka njeri gjë tjetër për nenin 77?

Dakord, me sugjerimin që të jetë transparent.

Po, vetëm një pyetje...

(Mungesë inçizimi.)

Entela Çipa - Jo, furnizuesi zgjidhet, se rrjetet, transmetimi dhe shpërndarja janë, nuk mundet të zgjidhen.

Fatmir Xhafaj - Furnizuesi po.

(Mungesë incizimi.)

Entela Çipa - Transmetimi dhe shpërndarja janë dy sisteme monopol. Furnizimi dhe gjenerimi janë të liberalizuar dhe në këtë ligj garantohen.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo OSHEE , furnizues.

Agim Bregasi - OSHEE-ja brenda ka rrjetin, ka edhe operatorin e furnizimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Entela Çipa - Do të paguash vetëm tarifat me transmetim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do të paguash vetëm dy tarifat e transmetimit dhe shpërndarjes.

(Diskutime pa mikrofon.)

Agim Bregasi - Jo, jo. T’ia shpjegojmë edhe zotit Fino. Pra, nuk ia blen OSHEE-së, por energjinë ti mund ta gjeshe nga importi, nga vendi, nga hidrocentralet, nga KESH-i si operator furnizues, jo nga OSHEE-ja. Po ta marrim si një kuadrat OSHEE-në, ka dy: ka rrjetin, pra linjat, kabllo, ka edhe furnizimin. Kjo e linjave do të ngelet OSHEE dhe ka një tarifë transmetimi që nuk varet nga OSHEE-ja, por e cakton ERE-ja. Furnizuesit duhet të jenë disa, 1, 2, 3, 5.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, në qoftë se ty nuk të pëlqen ky furnizues, në ligj detyron edhe ERE-n që të përcaktojë kushtet se si kalon nga një operator tek tjetri. Është pa shpërblim, pra nuk paguan për të kaluar nga një operator tek tjetri, por ka disa detyrime, dhe nuk ke dy karta, ke një. Do të dorëzosh atë që kishe dhe do të marrësh kartën tjetër.

Entela Çipa - Ke mundësi të zgjedhësh edhe dy furnizues njëkohësisht mbi baza orare.

Agim Bregasi - Jo njëkohësisht, se nuk ke...

Entela Çipa - Mbi baza orare, një klient industrial, klientët e mëdhenj që kanë...

(Diskutime pa mikrofon.)

Po, mund të furnizohesh edhe me baza orare.

Agim Bregazi - Po, me baza orare, por jo hoqe atë, merre këtë. S'ke si e merr në moment.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Bashkim Fino - Gjithë këto hidrocentrale që janë, e kanë kontratën me KESH-in? Me kë e kanë?

Entela Çipa - Po, aktualisht e kanë me KESH-in.

(Mungesë inçizimi.)

Bashkim Fino - Po unë nuk dua të bëj marrëveshje me KESH-in.

Entela Çipa - Kjo është risi. Hapja e tregut për klientët industrial me detyrim, do të hapë treg edhe për prodhuesit. Ata do të lidhen direkt me prodhuesit këtej e tutje.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Bashkim Fino - Kur hyn në fuqi kjo? "Pastaj aktet nënligjore ose akte të tjera ligjore në funksion të tyre".

Entela Çipa - Shumica e akteve nënligjore janë parashikuar 6 muaj, prandaj mendojmë që brenda vitit të plotësohet me të gjitha aktet.

Bashkim Fino - Duhet shënuar kjo që tha.

Fatmir Xhafaj - Po.

Neni 78, dakord?

(Diskutim pa mikrofon.)

Vasilika Hysi - Neni 78. Po, më falni!

Bashkim Fino - Vërtet, se është shumë interesante.

Bashkim Fino - Aktet nënligjore apo akte të tjera ligjore në funksion të këtij neni janë shumë të rëndësishme, sepse ne nuk duhet të ngelemi skllav i një projektligji shumë të

rëndësishëm që bëjmë dhe ngelet në ligj, dhe nuk bëjmë akte të tjera nënligjore që janë funksionale.

Sapo u bënë disa pyetje nga unë dhe nga ju, zoti kryetar, për çështjen në praktikë. Atëherë, si do të bëhet kjo? Kur do të bëhet? Këta thonë për 6 muaj, por kam përshtypjen se nuk bëhen dot kaq shpejt.

Fatmir Xhafaj - Ju lutem, mbajini shënim, Ulsi, kur të vemi te neni 108, shënoje aty që ta riformulojë zoti Fino dhe ta debatojmë.

Zonja Hysi, te neni 78?

Vasilika Hysi - Në nenin 78, zoti kryetar, kam një pyetje për fjalinë e dytë të paragrafit të parë. Ju thoni që “klientët punëtorë janë përgjegjës përballë furnizuesit për disbalancat e shkaktuara, përveç rasteve kur ERE vendos përjashtimin nga përgjegjësia për disbalancat për kategori të caktuara klientësh punëtorë, të cilët furnizohen mbi bazën e shërbimit universal të furnizimit, si edhe detyrimit të shërbimit publik”. Ç’doni të thoni me këtë, çfarë detyrimesh?

Çështja e dytë që kam për këtë nen, është mirë ta ndani të drejtën për informim të klientëve, zonja Çipa, dhe detyrimet, sepse janë dy gjëra të ndryshme.

Entela Çipa - Për sa i takon shqetësimit të parë, përveç rastit për disbalancat, për klientët fundorë është parashikuar që ERE mund të vendosë të mos jenë përgjegjës, pasi të gjithë operatorët e tjerë janë përgjegjës për disbalancat.

Disbalanca është diferenca ndërmjet programit dhe konsumit real. Pra, të gjithë prodhuesit e furnizuesit dhe klientët janë përgjegjës për disbalancat. Në këtë rast, për klientët fundorë, që janë parashikuar se cilët janë, nuk do të jenë përgjegjës për disbalancat, e vendos Enti Rregullator pasi...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, përveç rasteve kur ERE vendos që të mos jenë përgjegjës, sepse ne, ta bëjmë më të thjeshtë, konsumatorët familjarë, nuk mund të jemi përgjegjës, sepse ne nuk paraqesim një program, ndërsa të gjithë klientët e tjerë paraqesin një program, një ditë në avancë paraqesin një program, që “unë dua kaq energji për nesër”, dhe nëse ai nuk e respekton këtë program, është përgjegjës për dëmin që i ka shkaktuar operatorit të sistemit të transmetimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë kam 20 vjet që jam në sektorin e Energjisë.

(Diskutime pa mikrofon.)

Agim Bregasi – Shqetësimi është i drejtë, por këtu i lihet hapësirë ERE-s që të vendosë pikërisht te konsumatorët familjarë që nuk kanë ndikim secili tek e tek për disbalanca

dhe njëkohshmëria e rregullon vetë, si të thuash, te konsumatorët e vegjël, siç jemi ne familjarët. Në qoftë se kemi konsumatorë specifik, siç mund të jenë furra shkrirjeje...

Entela Çipa - Të gjithë të tjerët janë përgjegjës.

Agim Bregasi - Ose të mëdha, ata janë të detyruar që të kenë me OSHEE-në ose me furnizuesin një kontratë se sa energji do të konsumojnë në vit, sa në muaj, sa në javë dhe sa ditën që vjen.

Entela Çipa - Deri në ditën në avancë, pra kanë detyrime për një ditë përpara.

Fatmir Xhafaj - Neni 78 po e lëmë të hapur, sepse edhe unë nuk jam shumë i qartë për këtë gjë, mesa shoh edhe kolegët.

Arben Bregasi - Jo, kjo është e qartë për ne.

Entela Çipa - Një sqarim të lutem, që familjarët nuk do të jenë përgjegjës, ky është detyrimi për disbalancat.

Fatmir Xhafaj – Shkruajeni, zonjë.

Ulsi, shkruaje! Shkruajeni, zonjë, e shkruara mbetet, fjalën e merr era, kanë thënë.

Shënojeni te neni 78 për të përcaktuar përgjegjësinë ose jo të konsumatorëve familjarë.

Dakord?

Neni 78 mbetet për t'u riparë.

Neni 79, “Shërbimi universal i furnizimit si detyrim i shërbimit publik”.

Ulsi Manja - Dakord.

Fatmir Xhafaj - Neni 80, “Të drejtat e furnizuesit”, dakord?

Ulsi Manja - Dakord.

Fatmir Xhafaj - Neni 81, “Kushtet për çmimet e rregulluara”, dakord?

Ulsi Manja – Dakord.

Fatmir Xhafaj - Neni 82, “Furnizuesi i mundësisë së fundit”, dakord?

Ulsi Manja – Dakord.

Fatmir Xhafaj - Neni 83, “Përcaktimi i furnizuesit së alternativës së fundit”, dakord?

Ulsi Manja - Dakord.

Fatmir Xhafaj - Neni 84, “Furnizimi për klientët në nevojë”.

Ulsi Manja - Dakord.

Fatmir Xhafaj - Neni 85, “Rregullat për ndryshimin e furnizuesit”, dakord?

Ulsi Manja - Dakord.

Fatmir Xhafaj - Neni 86, “Ruajta e të dhënave”, dakord?

Ulsi Manja - Dakord.

Fatmir Xhafaj - Neni 87, “Situata emergjente për furnizimin me energji elektrike”, dakord?

Ulsi Manja - Dakord.

Fatmir Xhafaj - E mbylлим te neni 87, sepse te neni 88, seksioni i dytë, do t’i kërkojmë ministrit që të jetë në komision.

E thashë edhe herën e parë, por, siç duket nuk e keni njoftuar, ndaj ministri nuk është, sepse jam i bindur që ai do të vinte. Ndaj e shtyva, sepse duhet të ishte ministri, por nuk ka problem, e përballuat shumë mirë edhe ju dhe u sqaruam. Por, për këtë nen, bashkë me nenin që kemi lënë pezull, duhet të jetë ministri në komision.

E mbylлим këtu.

Faleminderit për kontributin tuaj!

Nesër, sipas rendit të ditës, kemi projektligjet “Për lojërat e fatit”, “Kodi Rrugor”, “Shërbimi postar”, pika e tretë.

Më pas janë dy raportet e komisionerit “Për të Drejtën e Informimit dhe i KQZ-së”.

(Diskutime pa mikrofon.)

Mbledhja mbyllet.

MBLEDHJA MBYLLET

